



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 451/ 2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Ferit Osmani dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Lipjan, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Lipjan, për shkak të pa rregullsive gjatë procesit të votimit, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 07.11.2013, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Lipjan.

Arsyetim

Me datën 03.11.2013, subjekti politik PDK, ka parashtruar ankesë në PZAP, në të cilën ankesë pretendon, se në Qendër e Votimit Babush i Muhaxherve –Lipjan, anëtar i LDK-së Skender Toshalli, ka frikësuar dhe kërcënuar votuesit në këtë Qendër të votimit. Lidhur me këtë rast është njoftuar dhe Policia e Kosovës.

Në Raportin Policisë së Kosovës me nr. 2013-AH- 1368 për te dyshuarin Skender Toshalli, theksohet se për rastin në fjalë Policia e Kosovës me datën 03.11.2013, ka iniciuar rastin në të cilën theksohet se ndaj të dyshuarit është iniciuar rasti – Moszbatim i Urdhrave të Policisë.

Arsyeja pse është iniciuar rasti në polici është për moszbatim të moszbatimit të urdhrave për ndalim nga policia, ndërsa lidhur me dyshim për armbajtje, në raport theksohet se të njëjtit nuk ju ka gjetur asgjë e dyshimit pas ndalimit.

PZAP-i pasi që shqyrtoj shkresat e lëndës gjeti se;

Ankesa është e pabazuar.

PZAP-i, konstatoi se pretendimet e ankimore nuk qëndrojnë pasi nuk janë provuar me asnjë dëshmi nga pala ankuese që pretendohet në ankesë, kjo vërtetohet edhe nga raporti i policisë me nr. 2013-GM-23, prandaj PZAP-i në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 451/2013 më datën 07.11.2013

Kryesuesi i panelit
Hasan Shala

Këshillë Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*